



AAB College


KOLEGJI AAB

**RAPORT I VLERËSIMIT TË STAFIT AKADEMIK NGA STUDENTËT
FAKULTETI EKONOMIK**

Zyra e Sigurimit të Cilësisë
Shkurt 2023


Ky raport përmbledhës paraqet vlerësimin e përgjithshëm të studentëve të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB për vlerësimin e stafit akademik të programeve të studimit të nivelit Bachelor dhe Master. Në vlerësim janë përfshirë të gjithë studentët e Fakultetit Ekonomik të cilët kanë bërë plotësimin e pyetësorëve me rastin e paraqitjes së provimeve pas përfundimit të semestrit dimëror. Pyetësi për vlerësimin e stafit akademik përbëhet nga 6 pyetje dhe studentët janë përgjigjur sipas shkallës së Likertit në 5 nivele të ndryshme të pajtueshmërisë nga “nuk pajtohem aspak” deri në “pajtohem plotësisht”. Në vazhdim, për çdo pyetje të pyetësorit janë paraqitur në formë grafike vlerësimet e përgjithshme të studentëve, ndërsa, në fund të raportit janë dhënë rekomandime të përgjithshme për përmirësim.

Figura 1. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për përgatitjen dhe kompetencat e stafit akademik




Në figurën më sipër është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për përgatitjen dhe kompetencat e stafit akademik për lëndët të cilat ata i ligjërojnë. Sipas rezultateve të vlerësimit, profesorët e Fakultetit Ekonomik kanë qenë të përgatitur për ligjërimin e lëndëve të tyre si dhe kanë treguar kompetencë për lëndët, një konstatim i cili mbështetet me rreth 49.86% të studentëve të cilët kanë deklaruar se pajtohen plotësisht për përgatitjen dhe kompetencat e stafit akademik. Një përqindje më e vogël, përkatësisht rreth 14.97% të studentëve janë shprehur neutral ndërsa vetëm 2.72% e studentëve janë deklaruar se nuk pajtohen aspak.

Figura 2. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për respektimin dhe përmbajtjen e syllabusit nga ana e stafit akademik




Më lartë janë paraqitur të dhënat e vlerësimit të studentëve të Fakultetit Ekonomik për respektimin e përmbajtjes së syllabusit nga ana e stafit akademik. Rezultatet e paraqitura më sipër tregojnë se syllabuset e lëndëve të prezantuara në fillim të semestrit janë respektuar nga ana e profesorëve përgjatë semestrit ku rreth 80.21% e studentëve kanë pajtueshmëri të plotë me këtë deklaram, 14.54% të studentëve janë shprehur neutral ndërsa vetëm 2.65% e studentëve janë deklaruar se nuk pajtohen aspak me këtë deklaram.

Figura 3. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për format e mësimdhënies dhe angazhimin e tyre në klasë nga stafi akademik




Në figurën më lartë, është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për format e mësimdhënies dhe angazhimin e tyre në klasë nga stafit akademik. Rezultatet e paraqitura më sipër tregojnë se profesorët përdorin forma të ndryshme të mësimdhënies me qëllim të angazhimin të studentëve. Rreth 75.08% e studentëve e kanë pohuar një deklaram të tillë, 16.94% e studentëve janë shprehur neutral dhe vetëm 3.09% e studentëve kanë deklaruar se nuk pajtohen aspak.

Figura 4. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për vlerësimin e detyrave, projekteve dhe punimeve nga stafi akademik




Në figurën e mësipërme janë paraqitur të dhënat e vlerësimit të studentëve për vlerësimin e detyrave, projekteve dhe punimeve nga ana e stafit akademik. Rezultatet e paraqitura tregojnë se profesorët e Fakultetit Ekonomik vlerësojnë drejtë detyrat, projektet dhe punimet e studentëve dhe kjo vërtetohet me rreth 78.93% të deklarameve të studentëve të cilët pajtohen me këtë konstatim, 15.23% e studentëve janë shprehur neutral dhe 2.59% e studentëve kanë deklaruar se nuk pajtohen aspak.

Figura 5. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për inkurajimin, pjesëmarrjen aktive, të menduarit kritik dhe të pavarur nga stafi akademik



Në figurën më lartë është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për inkurajimin, pjesëmarrjen aktive, të menduarit kritik dhe të pavarur nga stafi akademik. Rezultatet e paraqitura tregojnë se profesorët inkurajojnë studentët që të zhvillojnë mendimin kritik dhe inkurajojnë interaktivitetin në klasë. Rreth 77% e studentëve janë deklaruar se pajtohen me këtë deklaram, 16.20% e studentëve janë shprehur neutral dhe vetëm 2.64% e studentëve kanë deklaruar se nuk pajtohen aspak me këtë deklaram.

Figura 6. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit Ekonomik për gatishmërinë e stafit akademik në përgjigjen ndaj kërkesave të tyre



Më sipër janë paraqitur të dhënat e përgjithshme të vlerësimit të studentëve të Fakultetit Ekonomik për gatishmërinë e stafit akademik për t'iu përgjigjur kërkesave të studentëve. Rezultatet e paraqitura tregojnë se profesorët kanë treguar gatishmëri për të iu përgjigjur të gjitha kërkesave të studentëve me rreth 80% të studentëve të cilët kanë deklaruar se pajtohen me këtë deklaram, 16.38% e studentëve janë shprehur neutral dhe 2.00% e studentëve janë deklaruar se nuk pajtohen aspak.

Shtojca 1

Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Ekonomik për stafin akademik

Pyetja	Nuk Pajtohem Aspak	Nuk Pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem Plotësisht
Mësimdhënësi/ja ka qenë i/e përgatitur dhe ka treguar kompetencë për lëndën	2.72%	3.40%	14.97%	29.08%	49.86%
Mësimdhënësi/ja ka respektuar përmbajtjen e syllabusit të prezantuar në fillim të semestrit	2.65%	2.60%	14.54%	30.59%	49.62%
Format e mësimdhënies kanë qenë atraktive dhe kanë mundësuar angazhimin e studentëve në klasë	3.09%	4.89%	16.94%	30.31%	44.77%
Mësimdhënësi/ja ka vlerësuar drejtë të gjitha detyrat/ projektet/punimet/ e mia	2.59%	3.25%	15.23%	31.97%	46.96%
Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar pjesëmarrjen aktive, të menduarit kritik dhe të pavarur të studentëve	2.64%	4.32%	16.20%	30.87%	45.97%
Mësimdhënësi/ja i është përgjigjur në kohë të gjitha kërkesave të mia	2.00%	2.84%	16.38%	30.99%	47.79%